

## Llogaritë financiare sektoriale: Shënime metodologjike

**Llogaritë financiare sektoriale**, me frekuencë vjetore, hartohen nga Banka e Shqipërisë (BSH). Për hartimin dhe raportimin e tyre, BSH-ja mbështetet në standardet metodologjike ndërkombëtare, mbi të cilat është ngritur dhe funksionon hartimi dhe raportimi i llogarive financiare në vendet anëtare të Bashkimit Evropian, si më poshtë:

- Sistemi Evropian i Llogarive Kombëtare, ESA 2010;
- Manuali mbi Burimet dhe Metodat e Hartimit të Llogarive Financiare – Edicioni i Dytë;
- Rregullore 549/2013 (BE) mbi sistemin Evropian të Llogarive Kombëtare dhe Rajonale në Bashkimin Evropian.

Sistemi Evropian i Llogarive Kombëtare (ESA 2010) është një standard ndërkombëtar, që shërben për hartimin e statistikave të llogarive financiare, për të gjitha vendet në Evropë.

Të dhënat për hartimin e llogarive financiare sigurohen në mënyrë direkte nga institucionet raportuese si burim primar, ose në mënyrë indirekte nga informacioni kundërparti. Për mbledhjen e të dhënave parësore, statistikat e llogarive financiare përdorin gjerësisht të dhënat e raportuara në BSH, në përputhje me mandatin e saj si agjenci statistikore. BSH-ja e grumbullon informacionin statistikor nëpërmjet Sistemit të Unifikuar të Raportimit (ERRS), si dhe nëpërmjet kanaleve të tjera të raportimit pranë saj. Ndërkohë, burime shtesë përdoren për të plotësuar pamjaftueshmërinë e burimeve parësore ose për të rritur cilësinë e statistikave. Si burim kryesor informacioni për hartimin e llogarisë financiare shërbejnë dy blloqe të rëndësishme statistikore të BSH-së: statistikat monetare dhe statistikat e sektorit të jashtëm të ekonomisë. Të dhënat për hartimin e llogarive financiare mund të sigurohen nga secili prej dy pjesëmarrësve në çdo transaksion financiar<sup>1</sup>. BSH-ja bashkëpunon<sup>2</sup> me Institutin i Statistikave (INSTAT) dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (MFE), që të mund të përdoren maksimalisht dhe në mënyrë eficiente të dhënat administrative.

Një çështje që trajtohet është rasti kur burime të ndryshme të të dhënave sigurojnë vlerësime kontradiktore. Ky rast kërkon që hartuesit e statistikave të vlerësojnë cilësinë relative të burimeve të ndryshme, duke kaluar në një hallkë tjetër të hartimit të llogarive financiare. Burimet e disponueshme kategorizohen sipas një hierarkie, e cila u jep prioritet burimeve parësore të informacionit, për shembull duke njohur faktin se të dhënat bankare janë më të besueshme se të dhënat e individëve.

Hapi i mëtejshëm është vendosja e gjithë informacionit në një format që përmban grupin e plotë të llogarive për të gjithë ekonominë. Kjo ndihmon në sigurimin e një blloku plotësisht të harmonizuar të llogarive financiare. Megjithatë, kjo nuk ndodh gjithmonë, për shkak të vlerësimeve të ndryshme kontabël, kohës së regjistrimit të transaksionit dhe konsideratave të tjera, duke shtruar nevojën e rregullimeve dhe përshtatjeve të mëtejshme deri në harmonizimin e plotë të llogarisë financiare.

## Metodologjia

Llogaritë financiare vjetore në Bankën e Shqipërisë përpilohen në përputhje me metodologjinë e Sistemit Evropian të Llogarive Kombëtare dhe Rajonale (ESA 2010). Rastet kur ka devijime nga ky standard detajohen më poshtë.

### 1.1 Rregullat kontabël

Regjistrimi i dyfishtë. Sistemi kombëtar i kontabilitetit bazohet në parimin e regjistrimit të dyfishtë. Secili transaksion duhet të regjistrohet dy herë, një herë si një burim (ose një ndryshim në pasive) dhe

---

<sup>1</sup> Përfashtim bën ari monetar, për të cilin, në konceptin statistikor, nuk ekziston një kundërparti.

<sup>2</sup> Marrëveshja e bashkëpunimit mes BSH-së, INSTAT-it dhe MFE-së u nënshkrua në fund të muajit shtator të vitit 2016. Ajo përcakton detyrat dhe përgjegjësitë institucionale të secilës agjenci, si në shkëmbimin e të dhënave dhe informacioneve që zotërohen nga institucionet përkatëse, ashtu dhe në prodhimin e treguesve/blloqeve statistikore dhe përgjegjësisë së raportimit të tyre në institucionet ndërkombëtare.

një herë si një përdorim (ose një ndryshim në aktive). Totali i transaksioneve të regjistruara si burime dhe totali i transaksioneve të regjistruara si përdorime duhet të jenë të barabartë, duke lejuar një element kontrolli mbi konsistencën e llogarive.

### **1.2 Rezidenca dhe territori**

Në përpilimin e llogarive financiare vjetore, rezidenca dhe territori janë në përputhje të plotë me përkufizimet e ESA 2010.

Vetëm njësitë me aktivitet ekonomik mbizotërues në Republikën e Shqipërisë, përfshihen në statistikat vjetore të llogarive financiare.

### **1.3 Përkufizimi i njësisë institucionale**

Në përpilimin e llogarive financiare vjetore, përkufizimi i njësisë institucionale është në përputhje me përkufizimet e ESA 2010.

Një njësi institucionale është një njësi ekonomike e karakterizuar nga autonomia në vendimmarrje në ushtrimin e funksionit të saj kryesor.

### **1.4 Koha e regjistrimit**

Koha e regjistrimit në llogaritë financiare vjetore korrespondon me standardin ESA 2010.

Kjo është e mundur në bazë të të dhënave të raportuara nga çdo institucion. Parimi *accrual* (rrjedhës) është një nga parimet më të rëndësishëm sipas Ligjit të Kontabilitetit. Interesi i përlllogaritur regjistrohet automatikisht në kontabilitetin e biznesit me instrumentin në të cilin ai akumulon ose në zërin *të tjera të arkëtueshme/të pagueshme*.

Përjashtim bëjnë të dhënat e sektorit të qeverisë, të cilat nuk hartohen plotësisht bazuar në parimin *accrual*.

### **1.5 Identifikimi i instrumentit**

Në llogaritë financiare, informacioni organizohet gjithashtu, edhe sipas llojit të transaksionit financiar, - të detajuar në 8 lloje kryesore të instrumenteve financiare. Klasifikimi i instrumenteve financiare konsideron kryesisht shkallën e likuiditetit, tregtueshmërinë, si dhe karakteristikat ligjore të mjeteve dhe detyrimeve financiare. Tabela 1 jep klasifikimin e instrumenteve financiare sipas ESA 2010.

Në përpilimin e llogarive financiare të Shqipërisë, përkufizimet e instrumenteve financiare janë në përputhje me përkufizimet e ESA 2010. Në disa raste ka dallime të vogla, për shkak të burimit të të dhënave.

Në disa raste, kreditë brenda sektorit përfshihen gabimisht në instrumentin *llogari të tjera të arkëtueshme/të pagueshme* në kontabilitetin e biznesit.

### **1.6 Vlerësimi**

Vlerësimi i instrumenteve financiare është përgjithësisht në përputhje me rekomandimin e ESA 2010.

Në rastin e monedhës, depozitave, huave, llogarive të tjera të arkëtueshme/ të pagueshme dhe rezervave teknike, në llogaritë financiare, ashtu siç kërkohet në standardin ESA 2010, përdoret vlera nominale.

Për letrat me vlerë të borxhit të huaj, të cilat tregtohen në tregjet ndërkombëtare, përdoret vlera e tregut, ndërsa letrat me vlerë të qeverisë të tregtuara në tregun e brendshëm janë vlerësuar me vlerë nominale (çmimi i emetimit plus interesat e përlllogaritur).

Në vlerësimin e aksioneve dhe kapitalit tjetër përdoret vlera kontabël.

**Tabelë 1. Klasifikimi i instrumenteve financiare sipas ESA 2010**

<b>Instrumentet financiare</b>	<b>Përshkrimi</b>
Ari monetar dhe SDR (F.1/ AF.1)	Ari monetar është ari i zotëruar nga autoritetet monetare (ose që ndodhet nën kontrollin efektiv të tyre) dhe që mbahet me cilësinë e mjetit të rezervës. SDR janë mjete të rezervës të krijuara nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) për të plotësuar mjetet e tjera të rezervës që u janë akorduar periodikisht anëtarëve të FMN-së, në përpjesëtim me kuotat e tyre.
Paraja dhe depozitat (F.2/ AF.2)	Monedha dhe depozitat janë para në qarkullim dhe depozitat, si në monedhë vendase ashtu dhe në valutë të huaj
Letra me vlerë të borxhit (F.3/ AF.3)	Letra me vlerë të borxhit janë instrumente të tregtueshme financiare që shërbejnë si evidencë e borxhit.
Huatë (F.4/ AF.4)	Huatë përfaqësojnë aktive financiare, të cilat krijohen kur kreditorët u japin në mënyrë të drejtpërdrejtë debitorëve fonde hua dhe bëhen të evidentueshme me dokumente që nuk janë të negociueshme.
Aksione ose njësi të fondit të investimit (F.5/ AF.5)	Aksione ose njësi të fondit të investimit janë pretendimet e mbetura në aktivet e njësisë institucionale që kanë emetuar aksionet apo kuotat pasi të gjitha pretendimet e tjera janë shlyer.
Rezervat teknike dhe skemat e sigurimit të jetës dhe pensionit vjetor (F.6/ AF.6)	Rezervat teknike dhe skemat e sigurimit të jetës dhe pensionit vjetor përfaqësojnë rezerva teknike për sigurimin e jojetës, të drejta dhe pretendime për sigurimin e jetës apo fondet e pensionit.
Llogari të tjera të arkëtueshme/ pagueshme (F.8/ AF.8)	Llogari të tjera të arkëtueshme/ pagueshme janë aktive dhe detyrime financiare të krijuara si kundërparti e transaksioneve që kanë një diferencë kohore midis transaksionit dhe pagesave korresponduese.

### **1.7 Konsolidimi**

Llogaritë financiare hartohen kryesisht si llogari të pakonsoliduara. Rrjedhimisht, të gjitha aktivet dhe detyrimet financiare regjistrohen në llogari, pavarësisht nëse ato kanë të bëjnë me transaksionet jashtë apo brenda sektorit të monitoruar.

Banka e Shqipërisë përmbush raportimin e të dhënave të konsoliduara dhe të pakonsoliduara të llogarive financiare.

### **1.8 Klasifikimi sektorial**

Sistemi i llogarive evropiane (ESA2010) i klasifikon njësitë institucionale në bazë të aktivitetit kryesor ekonomik dhe sipas rolit që luajnë në ekonominë e vendit. Për qëllime të llogarive financiare, subjektet rezidente grupohen në pesë sektorë. Në Tabelën 2 paraqiten sektorët kryesorë të ekonomisë dhe kodet përkatëse në ESA 2010. Kur është e përshtatshme, sektorët rezidentë mund të ndahen më tej në nënsektorë sipas kriterëve specifike përkatëse për sektorin.

Çdo njësi institucionale klasifikohet vetëm në një sektor apo nënsektor.

Klasifikimi sektorial në llogaritë financiare të Shqipërisë është në përputhje me rekomandimin e ESA 2010.

Përfshimim në vetëm sektori i qeverisë së përgjithshme, i cili përfshin vetëm njësitë buxhetore të qeverisë qendrore, lokale dhe fondet e sigurimeve shoqërore dhe të kujdesit shëndetësor dhe nuk përfshin të dhënat e njërive ekstra-buxhetore, pjesë e qeverisë qendrore dhe lokale.

**Tabelë 1. Sektorët institucionalë sipas ESA 2010**

Sektorët institucionalë	Përshkrimi
Korporatat jofinanciare (S.11)	Përfshihen njësi institucionale, të cilat janë subjekte juridike të pavarura dhe prodhues tregu, aktiviteti kryesor i të cilëve është prodhimi i mallrave dhe shërbimeve jofinanciare.
Korporatat financiare (S.12)	Përfshihen njësi institucionale, të cilat janë subjekte juridike të pavarura dhe prodhues tregu, aktiviteti kryesor i të cilëve është ofrimi i shërbimeve financiare.
Qeveria e përgjithshme (S.13)	Përfshihen njësi institucionale të cilat janë prodhues jotregu ose kanë funksion kryesor rishpërndarjen e të ardhurave dhe pasurisë kombëtare, dhe në më shumë se 50% të aktivitetit financohen nga buxheti i qeverisë.
Ekonomitë familjare dhe NPISH (S.14+S.15)	Ekonomitë familjare dhe institucionet jo me qëllim fitimi (NPISH)
Ekonomitë familjare (S.14)	Ekonomitë familjare përbëhet nga individë dhe grupe individësh të cilët janë kryesisht konsumatorë. Ata ndajnë të njëjtën banesë, mbledhin një pjesë ose të gjitha të ardhurat dhe konsumojnë kolektivisht mallrat dhe shërbimet.
Institucionet jo me qëllim fitimi (S.15)	Përfshihen njësi ligjore të pavarura, u shërbejnë ekonomive familjare dhe nuk prodhojnë për tregun. Institucione të tilla i sigurojnë ekonomive familjare mallra dhe shërbime falas, ose me çmime që nuk janë ekonomikisht domethënëse.
Pjesa tjetër e botës (S.2)	Njësitë institucionale jorezidente përfshihen në llogaritë financiare vetëm në rast se ato janë të angazhuara në transaksione me njësi rezidente.

### 1.9 Përdorimi i vlerësimeve (*estimations*)

Marrëdhëniet financiare që nuk mbulohen me të dhëna nga sektori përkatës ose nga kundërpartitë janë objekt vlerësimi. Qëllimi ekonomik i vlerësimeve nuk është të krijojë një vlerë të saktë, por të sigurojë një informacion përfaqësues dhe cilësor që mund të përdoret për të identifikuar fortësinë e lidhjeve financiare dhe rreziqeve financiare në një masë relativisht të besueshme. Në mënyrë të ngjashme, një seri me vlera zero nuk do të thotë domosdoshmërisht se lidhja financiare nuk ekziston, por vetëm se ajo është e papërfillshme.

### 1.10 Politika e rishikimit

Të dhënat statistikore që shërbejnë në procesin e hartimit të llogarive financiare kanë kohë të ndryshme publikimi pas përfundimit të periudhës referuese, dhe gjithashtu bazohen në politika të ndryshme rishikimi. Ky fakt ndikon në rishikimin dhe publikimin e të dhënave të llogarive financiare. Llogaritë financiare rishikohen në rast rishikimi të të dhënave në statistikat monetare, statistikat e bilancit të pagesave dhe pozicionit ndërkombëtar të investimeve dhe statistikave financiare të qeverisë (GFS). Në përgjithësi, bëhen përpjekje për të përdorur informacionin më të fundit në dispozicion. Për rrjedhojë, së bashku me të dhënat për periudhën korrente, rregullisht rishikohen edhe të dhënat e periudhës paraardhëse. Sipas rastit, në afat më të gjatë, e gjithë seria kohore mund të rishikohet, edhe për shkak të ndryshimeve metodologjike apo standardeve ndërkombëtare.

Rishikimet bëhen në funksion të informacionit më të fundit të siguruar dhe kryhen në momente fikse të përpilimit të statistikave. Në rast ndryshimesh të metodologjisë apo standardeve ndërkombëtare, publikohet një dokument përmbledhës i veçantë.

Të dhënat e rishikuara, bazohen në politikat e rishikimit të Departamentit të Statistikave Financiare pranë BSH-së<sup>3</sup>.

## **Burimet e të dhënave dhe procedurat e vlerësimit**

### **Korporatat jofinanciare (S.11)**

Llogaria financiare e sektorit jofinanciar bazohet kryesisht në informacionin kundërparti, pasi të dhënat e raportuara për korporatat financiare, qeverinë dhe sektorin jorezident sigurojnë informacion të detajuar mbi marrëdhëniet e këtyre të fundit me korporatat jofinanciare. Të dhënat lidhur me marrëdhëniet ndërsektoriale dhe me sektorin e ekonomive familjare të korporatave jofinanciare sigurohen duke shfrytëzuar të dhënat e raportuara në pasqyrat financiare vjetore të kompanive. Baza e të dhënave për sektorin e korporatave jofinanciare u siguroi falë bashkëpunimit me INSTAT-in, në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit të nënshkruar në shtator të vitit 2016, si dhe në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

Këto të dhëna u përdorën për vlerësimin e kredisë brenda sektorit (biznes-biznes), si dhe instrumenteve aksione dhe kapitale të tjera (AF5) dhe llogari të arkëtueshme/pagueshme (AF8).

Statistikat për këto instrumente janë hartuar bazuar në të dhënat e raportuara në pasqyrat financiare të kompanive (burimi: kampioni INSTAT dhe QKB). Të dhënat e siguruarat i referohen kampionit përfaqësues dhe nuk janë aplikuar teknika *grossing up* të popullatës.

### **Sektori financiar S.12**

Si burim kryesor informacioni për hartimin e llogarisë financiare të sektorit të korporatave financiare përdoren të dhëna të raportuara pranë BSH-së nga bankat, shoqëritë e kursim kreditit dhe institucionet financiare jobanka. Të dhënat e nevojshme për hartimin e llogarisë financiare të fondeve të investimeve dhe të dhënat për kompanitë e sigurimit dhe fondet e pensioneve sigurohen nga bashkëpunimi me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare (AMF). Zyrat e këmbimit valutor (si pjesë e nënsektorit ndihmës financiar) raportojnë informacion pranë BSH-së për nevoja të hartimit të llogarive financiare. Të dhënat për ndihmësit e tjerë financiarë (të tillë si, shoqëri brokerimi në letra me vlerë, brokera në sigurime etj.) sigurohen nga informacioni i publikuar në faqen zyrtare të internetit të QKB-së.

### **Qeveria e përgjithshme S.13**

Qeveria e përgjithshme (S.13) përfshin ato njësi institucionale, të cilat janë prodhues jotregu ose të cilat kanë funksion kryesor rishpërndarjen e të ardhurave dhe pasurisë kombëtare, dhe ku më shumë se 50% e aktivitetit të tyre financohet nga buxheti i qeverisë. Në Shqipëri, sektori i qeverisë së përgjithshme përbëhet nga tre nënsektorë: qeveria qendrore (S.1311), qeveria lokale (S.1313) dhe fondet e sigurimeve shoqërore (S.1314). Përveç institucioneve buxhetore, sektori publik, bazuar në ESA 2010, përfshin edhe ndërmarrjet nën varësi ose që kontrollohen nga qeveria, të njohura si institucionet ekstra-buxhetore. Lista e plotë e njësive institucionale të klasifikuara në sektorin e qeverisë së përgjithshme është e publikuar në faqen zyrtare të internetit të INSTAT-it.

Të dhënat e llogarive financiare të sektorit të qeverisë përfshijnë vetëm të dhënat e njësive buxhetore, kjo për të ruajtur harmonizimin me statistikatat e tjera të publikuara, siç janë statistikatat financiare të qeverisë, llogaritë kombëtare etj.

---

<sup>3</sup> [https://www.bankofalbania.org/rc/doc/politika\\_e\\_rishikimit\\_te\\_statistikave\\_te\\_bsh\\_9773\\_1\\_1\\_9324.pdf](https://www.bankofalbania.org/rc/doc/politika_e_rishikimit_te_statistikave_te_bsh_9773_1_1_9324.pdf)

Për sektorin e qeverisë së përgjithshme, të dhënat raportohen nga MFE-ja (pjesë e MoU-së). Ky bllok të dhënash përmban informacion për nënsektorin e qeverisë qendrore, për nënsektorin e qeverisë lokale, fondet e sigurimeve shoqërore dhe ato të sigurimeve shëndetësore. Një tjetër vlerësim i aplikuar për sektorin e qeverisë së përgjithshme lidhet me instrumentin “aksione dhe kapital tjetër”. Në të dhënat fiskale dhe në GFS nuk ka ende një vlerësim zyrtar për këtë instrument, ndaj për vlerësimin e tyre në llogaritë financiare përdoret një nga tre metodat e sugjeruara në manualin ESA 2010, ajo e vlerësimit të vlerës kontabël (*book value*) të kapitalit të korporatave publike të raportuar në pasqyrat financiare nga këto kompani. Në rastin kur kompanitë publike vlerësojnë llogaritë e kapitalit të vet me vlerë negative (për shkak të humbjeve të mëdha), në llogaritë financiare kapitali i këtyre kompanive vlerësohet zero.

### **Ekonomitë familjare dhe institucionet jo me qëllim fitimi në shërbim të individëve S.14 dhe S.15**

Në mungesë të të dhënave të raportuara drejtpërdrejt nga burimi i informacionit për hartimin e këtij sektori, llogaria financiare e tyre është ndërtuar duke u mbështetur në informacionin kundërparti të siguruar nga sektorët e tjerë.

### **Jorezidentët (Pjesa tjetër e botës) S.2**

Rezidenca e çdo njësie institucionale është territori ekonomik me të cilin njësia ka lidhjen më të fortë, i shprehur si qendra dominuese e interesit ekonomik. Njësitë institucionale jorezidente përfshihen në llogaritë financiare vetëm në rast se ato janë të angazhuara në transaksione me njësi rezidente.

Hartimi i llogarive financiare për këtë sektor realizohet mbështetur në statistikat e prodhuara nga BSH-ja për bilancin e pagesave dhe pozicionin e investimeve ndërkombëtare. Përshtatja e statistikave të Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare dhe përkthimi i tyre në llogarinë financiare të jorezidentëve kalon përmes procesit të harmonizimit të të dhënave të dy sektorëve, duke kontrolluar dhe siguruar në këtë mënyrë konsistencën ndërsektoriale të të dhënave.